

KËRKESË

Kërkuese: Xhevrije Mara, e bija e Sulejmanit dhe Selvijes, e datëlindjes 10.2.1967, banuese në lagjen 14, Shkozë, Durrës.

Person i tretë i interesuar: Zyra e Gjendjes Civile Durrës

Objekti: Shpallja e zhdukjes së bashkëshortit tim Lutfi Mara

Bashkëshorti im Lutfi Jakup Mara, i datëlindjes 5.1.1962, ka dalë nga shtëpia më datë 10.5.1999, me një motor të vogël për të blerë disa gjëra dhe nuk u kthye më.

Më datë 12.5.1999 kemi edhe një denoncim në polici, e cila, përveç kërkimit nga ana e saj, na këshilloi të bënim edhe një denoncim në prokurori, ku çështjen në atë kohë e mori oficeri i policisë gjyqësore, Petrit Çevoli.

Që nga ai moment as unë, as njerëzit e tim shoqi dhe as tre fëmijët tanë nuk kemi dëgjuar asnjë të dhënë për të.

Po kështu edhe nga policia apo nga prokuroria nuk kemi marrë asnjë informacion të ri mbi të.

KËRKUESE
Xhevrije Mara